



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 dhjetor 2024
Nr. Ref.:RK 2593/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI258/23

Parashtrues

Shaban Hoti, Bedrije Hoti, Mirlindë Kelmendi, Mendim Hoti dhe Endrit Hoti

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 167/2023
të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 7 qershorit 2023**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Shaban Hoti, Bedrije Hoti, Mirlindë Kelmendi, Mendim Hoti dhe Endrit Hoti (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesit e kërkesës), të përfaqësuar nga Visar Morina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev. nr. 167/2023] të 7 qershorit 2023, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në ndërlidhje me Aktgjykimin [Ca. nr. 587/2022] të 27 shkurtit 2023, të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit).
3. Parashtruesit e kërkesës e kanë pranuar vendimin e kontestuar më 2 gusht 2023.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtruesve të kërkesës u janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa Individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 24 nëntor 2023, parashtruesit e kërkesës, dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata). Të njëjtën ditë, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin për përfaqësim.
7. Më 7 dhjetor 2023, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesve të kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
8. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi edhe Gjykatën Themelore në Pejë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) për regjistrimin e rastit dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesit e kërkesës e kanë pranuar vendimin e kontestuar.
9. Më 8 dhjetor 2023, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Enver Peci (anëtarë).
10. Më 4 janar 2024, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë dokumentin e kërkuar.
11. Më 26 nëntor 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 2 nëntor 2013, K.M, kishte shkaktuar një aksident trafiku i cili kishte rezultuar me vdekjen e I.M dhe M.H familjarë të parashtruesve të kërkesës, si dhe kishin mbetur të lënduar disa persona të tjerë.
13. Më 29 prill 2015, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [P.nr.985/13] shpalli fajtor K.M për kryerjen e veprës penale “Rrezikim i Trafikut Publik” nga paragrafi 9 i nenit 378 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme:KPRK) duke e dënuar me një vit burgim.
14. Më 21 mars 2019, parashtruesit e kërkesës kishin parashtruar padi për kompensim të dëmit material dhe jomaterial, në Gjykatën Themelore, në vlerë të përgjithshme prej 46.500 euro, ndaj Kompanisë së Sigurimeve “Sigma” me seli në Prishtinë, kompani kjo në të cilëm K.M si shkaktar i aksidentit kishte qenë i siguruar.
15. Në një datë të paspecifikuar, përfaqësuesi i Kompanisë së Sigurimeve “Sigma”, gjatë shqyrtimit kryesor në Gjykatën Themelore, kishte theksuar se padia e parashtruesve duhet refuzuar sepse e njëjta është parashkruar, me pretendimin se aksidenti kishte ndodhur më 2 nëntor 2013, ndërsa padia ishte parashtruar pas 5 viteve, respektivisht më 21 mars 2019.
16. Më 24 tetor 2019, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 320/19] vendosi si në vijim: (i) aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesve; (ii) detyroi Kompaninë e Sigurimeve “Sigma” që për kompensim të dëmit, respektivisht për dhimbje shpirtërore, t’ua paguaj satisfaksionin në lartësi si në vijim: Shaban Hoti kompensohet në vlerë 8.000 euro; Bedrije Hoti në vlerë 8.000 euro si dhe Mendim dhe Endrit Hoti, secilit i takon kompensimi nga 6.000 euro; (iii) detyrohet Kompania e Sigurimeve “Sigma” që të paguajë shpenzimet e procedurës; (iv) refuzohet padia e parashtruesve për kompensimin e dëmit material, respektivisht shpenzimet e varrimit; (v) refuzohet padia e parashtrueses Merlindë Kelmendi, e cila kishte kërkuar kompensim të dëmit për dhimbje shpirtërore.
17. Në një datë të paspecifikuar, Kompania e Sigurimeve “Sigma”, parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar se kjo e fundit nuk ka zbatuar drejt dispozitat ligjore, duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret kërkesëpadia ka qenë e parashkruar dhe se parashtruesit e kërkesës përgjatë procedurës penale të zhvilluar, kanë deklaruar se heqin dorë nga kompensimi i dëmit.
18. Më 27 shkurt 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [CA. nr. 587/2020] aprovoi ankesën e Kompanisë Sigurimeve “Sigma”, dhe refuzoi si të pathemeltë kërkesën e parashtruesve për kompensim të dëmit.
19. Gjykata e Apelit, në arsyetim të aktgjykimit të saj theksoi se parashtruesit e kërkesës nuk dëshmuar se brenda afatit prej 3 muajsh, nga data kur aktgjykimi penal ndaj K.M kishte marrë formën e prerë, kishin parashtruar padi në gjykatën kompetente, ashtu edhe siç parashihet me nenin 362 (Afatet e parashkrimit të kontratat për sigurimin) dhe paragrafin 2 të nenit 371 (Hedhja poshtë e padisë për shkak të jokompetencës) të Ligjit L. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në tekstin e mëtejme:LMD). Gjykata e Apelit konsideroi se Kompania e Sigurimeve “Sigma” kishte dëshmuar se parashtruesit e kërkesës “brenda afateve të parapara me nenin 362 lidhur me nenin 371 të LMD-së, nuk kanë ndërmarrë

veprime me efekt juridik për ndërprerjen e parashkrimit”. Për më tepër Gjykata e Apelit thekson se “ nga data 25.05.2015, kur aktgjykimi penal është bërë i formës së prerë, e deri më datën 21.03.2019, kur paditësit e kanë paraqitur padinë në gjykatën e shkallës së parë, kanë kaluar më tepër se 3 muaj, kurse nga data 02.11.2013, kur paditësit pretendojnë se u është shkaktuar dëmi kanë kaluar më tepër se 3 përkatësisht më tepër se 5 vite, afat ligjor i paraparë me nenin 362 të LMD, brenda së cilit paditësit mund të kërkonin realizimin e të drejtës së tyre përmes mbrojtjes gjyqësore, në procedurë kontestimore.

20. Më 31 mars 2023, parashtruesit e kërkesës parashtruan revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të larekur të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesit në mënyrë specifike në Gjykatën Supreme pretenduan se aktgjykimi i shkallës së dytë ishte i paarsyetuar.
21. Më 7 qershor 2023, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 167/2023] refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesve të kërkesës dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, duke e konsideruar të njëjtin si të drejtë dhe të ligjshëm. Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj, ndër të tjera, konsideroi se Gjykata e Apelit kishte dhënë arsye të mjaftueshme dhe kishte zbatuar drejtë dispozitat ligjore kur kishte refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

22. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se përmes vendimeve të kontestuara, atyre u janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
23. Parashtruesit e kërkesës së pari pretendojnë se Gjykata Supreme me rastin e refuzimit të revizionit të parashtruesve të kërkesës, nuk kishte dhënë arsyetim të mjaftueshëm lidhur me çështjen e parashkrimit absolut dhe relativ, duke shtuar se e njëjta nuk kishte adresuar pretendimin e tyre lidhur me aplikimin e nenit 358 (Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale) të LMD-së, në rastin konkret.
24. Sipas parashtruesve të kërkesës, LMD-ja çështjen e kërkesave të shpërblimit të dëmit e ka kategorizuar në dy nene të veçanta, respektivisht nenin 357 (Kërkesa e shpërblimit të dëmit) dhe nenin 358 (Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale). Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Supreme në rastin konkret gabimisht ka aplikuar dispozitat e nenit 357 të LMD-së lidhur me parashkrimin, dhe sipas tyre në rastin konkret duhej të aplikohesh neni 358 i LMD-së, duke shtuar se “ kur dëmi është shkaktuar me vepër penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë i parashkrimit, kërkesa për shpërblim të dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të kaloj koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale dhe se në këtë rast gjen zbatim neni 358 i LMD-së.”
25. Pretendimi thelbësor i parashtruesve të kërkesës është mungesa e arsyesimit të vendimit të kontestuar, duke theksuar se i njëjti “nuk përmban asnjë arsyetim se përse Gjykata mbështetet në nenin 357 të LMD-së te kërkesa për shpërblim të dëmit në rastet kur shkaktimi i dëmit është rezultat i veprës penale të vërtetuar me aktgjykim të formës së prerë dhe se me këtë veprim është shkelur esenca e së drejtës së Parashtruesit për një vendim gjyqësor të arsyetuar.[...] kur dëmi është shkaktuar me vepër penale dhe për

ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblim të dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale dhe se në këtë rast gjen zbatim neni 358 i LMD-së”.

26. Sipas parashtruesve të kërkesës, neni 358 i LMD-së, aplikohet kur (i) ka një vendim gjyqësor “*me të cilin konfirmohet se është kryer vepra penale*”; (ii) shkaktimi i dëmit është si pasojë e veprës penale dhe (ii) afati i paraqitjes së kërkesës për shpërblim të dëmit të mos ketë kaluar afatin e paraparë për parashkrimin e ndjekjes penale. Sipas tyre në rastin konkret të gjitha këto kritere janë përmbushur.
27. Në mbështetje të pretendimeve të tyre për një vendim të arsyetuar gjyqësor, parashtruesit e kërkesës thirren në një numër rastesh të GJEDNJ-së, respektivisht , *Van De Hurk kundër Holandës*, kërkesa nr. [16034/90](#) Aktgjykim i 19 prilli 1994, *Buzescu kundër Rumanisë*, kërkesa nr. [61302/00](#), Aktgjykim i 24 majit 2005, *Pronina kundër Ukrainës*, kërkesa nr. [63566/00](#), Aktgjykim i 18 korrikut 2006, *Hadjianstassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992, si dhe në praktikën e Gjykatës, respektivisht rastet KI87/18, parashtrues [IF Skadeforsking](#), Aktgjykim i 27 shkurtit 2019.
28. Më tej, parashtruesit e kërkesës para Gjykatës shtojnë se dështimi i Gjykatës Supreme për të dhënë arsyetim të mjaftueshëm cenon parimin e sigurisë juridike dhe “*pamundëson respektimin e praktikës së deritanishme gjyqësore në çështje të ngjashme*”.
29. Parashtruesit e kërkesës në mbështetje të pretendimit për cenim të parimit të sigurisë juridike theksojnë se Gjykata Supreme dhe gjykatat e instancave më të ulëta në raste të ngjashme kanë nxjerrë vendime të ndryshme. Parashtruesit e kërkesës në mbështetje të këtij pretendimi në Gjykatë kanë dorëzuar 3 (tri) vendime të gjykatave të rregullta, respektivisht dy vendime të Gjykatës Themelore dhe një të Gjykatës së Apelit.
30. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Supreme në rastin konkret nuk e ka respektuar praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, respektivisht standardin e vendosur nga kjo e fundit lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Parashtruesit e kërkesës janë thirrur në një numër rastesh të Gjykatës Kushtetuese, KI55/09, parashtrues [NTSH Meteorit](#), Aktgjykim i 6 prillit 2011, KI135/14 parashtrues [IKK Classic](#), Aktgjykim i 10 nëntorit 2015, KI97/16, parashtrues [IKK Classic](#), Aktgjykim i 4 dhjetorit 2017, KI 138/15 parashtrues “[Sharr Beteiligungs GMBH](#)” [SH.P.K](#), Aktgjykim i 4 shtatorit 2017.
31. Në fund, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që ta anulojë vendimin e kontestuar, si rezultat i shkeljeve të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
2. *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër*

saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”

[...]

Konventa Evropiane për të Drejta të Njeriut

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

LIGJI Nr. 04/L-077 PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE

Neni 357 Kërkesa e shpërblimit të dëmit

1. Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijëni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin.
2. Në çdo rast kjo kërkesë parashkruhet për pesë (5) vite nga shkaktimi i dëmit.
3. Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me cenimin e detyrimit kontraktues parashkruhet për kohën e caktuar për parashkrimin e atij detyrimi.
4. Kërkesat e kompensimit të dëmit të krijuar nga akti i abuzimit seksual me të mitur parashkruhen pesëmbëdhjetë (15) vite pasi personi i mitur të ketë arritur moshën e pjekurisë.

Neni 358 Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale

1. Kur dëmi është shkaktuar me vepër penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblim të dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale.
2. Ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale sjell edhe ndërprerjen e parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit.
3. E njëjta vlen edhe për ndaljen e parashkrimit.

Neni 362 Afatet e parashkrimit të kontratat për sigurimin

1. Kërkesat e kontraktuesve të sigurimit, respektivisht të personit të tretë nga kontrata e sigurimit të jetës, parashkruhen për pesë (5) vjet, kurse nga kontratat e tjera për sigurimin për tre (3) vjet, duke llogaritur që nga dita e parë pas kalimit të vitit kalendarik në të cilin është krijuar kërkesa.

2. Në qoftë se personi i interesuar provon se deri në ditën e caktuar në paragrafin paraprak nuk ka ditur se rasti i siguruar ka ndodhur, parashkrimi fillon që nga dita kur të ketë marrë dijeni për këtë, ashtu që në çdo rast kërkesa parashkruhet te sigurimi i jetës për dhjetë(10) vjet, kurse te sigurimet e tjera për pesë (5) vjet nga data e caktuar në paragrafin paraprak. 3. Kërkesat e siguriesit nga kontratat e sigurimit parashkruhen për tre (3) vjet.

4. Nëse i dëmtuari në rastin e sigurimit nga përgjegjësia kërkon shpërblim nga i siguruari, ose shpërblimin e ka marrë prej tij, parashkrimi i kërkesës të të siguruarit ndaj siguriesit fillon që nga dita kur personi i dëmtuar ka kërkuar në rrugë gjyqësore shpërblimin nga i siguruari, respektivisht kur i siguruari t'ia ketë shpërblyer dëmin. 5. Kërkesa e drejtpërdrejtë e personit të tretë të dëmtuar ndaj siguriesit parashkruhet për të njëjtën kohë për të cilën parashkruhet kërkesa e tij ndaj të siguruarit përgjegjës për dëmin. 6. Parashkrimi i kërkesës që i takon siguriesit ndaj personit të tretë përgjegjës për paraqitjen e rastit të sigurimit fillon të rrjedhë kur fillon edhe parashkrimi i kërkesës së të siguruarit ndaj këtij personi, dhe mbaron në të njëjtin afat.

Neni 371

Hedhja poshtë e padisë për shkak të jokompetencës

1. Në qoftë se padia kundër debitorit është hedhur poshtë për shkak të jo kompetencës së gjykatës ose për ndonjë arsye tjetër i cili nuk i përket esencës së çështjes, kështu që kreditori përsëri paraqet padi brenda afatit prej tre (3) muajsh nga data kur vendimi mbi hedhjen poshtë të padisë të ketë marrë formën e prerë do të konsiderohet se parashkrimi është ndërprerë me padinë e parë.

2. E njëjta gjë vlen edhe për thirrjen në mbrojtje si dhe për paraqitjen e kompensimit të kërkesës në kontest si dhe në rastin kur gjykata ose ndonjë organ tjetër e ka drejtuar debitorin që kërkesën e tij të deklaruar ta realizojë në procedurë civile

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

32. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

1. *Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

34. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individu mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.

35. Gjykata nga si më sipër konstaton se parashtruesit e kërkesës janë: (i) palë e autorizuar; (ii) kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 167/2023] të 7 qershorit 2023 të Gjykatës Supreme; (iii) kanë saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendojnë se u janë shkelur; (iv) kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj; si dhe (v) e kanë dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.
36. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, pika d) e paragrafit 1 dhe paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcaktojnë që:

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(d) Kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

[...]

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.

37. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që

kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta”. Këtë koncept të papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara” të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata i ka përvetësuar edhe në praktikën e saj gjyqësore, përfshirë, por duke mos u kufizuar në rastet [KI40/20](#), parashtrues *Sadik Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 janarit 2021; [KI163/18](#), parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; [KI21/21](#), parashtrues, *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 prillit 2021, [KI107/21](#), parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 tetorit 2021).

38. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit si dhe pretendimet përkatëse të parashtruesve të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
39. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës për kompensim të dëmit material dhe jomaterial, në vlerë të përgjithshme prej 46.500 euro në Gjykatën Themelore, ndaj Kompanisë së Sigurimeve “Sigma”, kompani kjo në të cilën kishte qenë i siguruar K.M si shkaktar i aksidentit në të cilin kishte humbur jetën familjari i parashtruesve të kërkesës. Parashtruesit, kërkesëpadinë për kompensim të dëmit e kishin parashtruar më 21 mars 2019. Më 24 tetor 2019, Gjykata Themelore aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës dhe e detyroi Kompaninë e Sigurimeve “Sigma” që për kompensim të dëmit, për dhimbje shpirtërore, t’ua paguajë satisfaksionin në lartësi si në vijim, Shaban Hoti kompensohet në vlerë 8.000 euro; Bedrije Hoti në vlerë 8.000 euro si dhe Mendim dhe Endrit Hoti, secilit i takon kompensimi nga 6.000 euro. Kundër vendimit të shkallës së parë, Kompania e Sigurimeve “Sigma”, parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar, ndër të tjera, se në rastin konkret bazuar në nenin 357 të LMD-së, ishte arritur parashkrimi. Gjykata e Apelit miratoi ankesën e Kompanisë së Sigurimeve “Sigma”, dhe refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesve të kërkesës, me arsyetimin se e njëjta ishte parashkruar. Gjykata Supreme, pas revizionit të paraqitur nga parashtruesit e kërkesës miratoi në tërësi aktgjykimin e Gjykatës Apelit.
40. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë konstatimet e mësipërme të Gjykatës Supreme, duke pretenduar se me aktgjykimin e kontestuar u janë shkelur të drejtat e tyre të mbrojtura me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
41. Në thelb, Gjykata vëren se esenca e pretendimeve të tyre në Gjykatë, ka të bëjë me: (i) pretendimin për mungesë të një vendimi të arsyetuar gjyqësor, si rezultat i zbatimit të gabuar të ligjit; si dhe (ii) pretendimin për shkelje të parimit të sigurisë juridike si rezultat i vendimeve kundërtënëse.

I. Pretendimet përkitazi me mosarsyetim të vendimit gjyqësor

42. Lidhur me pretendimin e tyre për mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor të cilin parashtruesit e ndërlidhin edhe me zbatim të gabuar të ligjit, Gjykata së pari do të paraqesë parimet e përgjithshme përkitazi me vendimin e arsyetuar gjyqësor dhe më pas të njëjtat do t'i aplikojë në rrethanat e rastit konkret.
- (i) *Parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar*
43. Garancitë e mishëruara në nenin 6, paragrafin 1 të KEDNJ-së, përfshijnë edhe detyrimin e gjykatave që të paraqesin arsyetim të mjaftueshëm për vendimet e tyre (shih, rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, nr. 8950/80, Aktgjykim i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k.*, Aktgjykim i 15 dhjetorit 2022, paragrafi 113). Vendimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë.
44. Përkundër faktit që gjykata e brendshme ka një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe vendosjes për pranueshmërinë e dëshmive, ajo është e detyruar të justifikojë veprimet e saj duke arsyetuar të gjitha vendimet e saj (shih, rastet e GJEDNJ-së *Suominen kundër Finlandës*, nr. 37801/97, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 36; *Carmel Saliba kundër Maltës*, nr. 24221/13, Aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73; dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k.*, cituar më lart, paragrafi 114).
45. Gjykata më e ulët ose autoriteti shtetëror, nga ana tjetër, duhet të japin arsye dhe arsyetime të tilla të cilat do t'u mundësojnë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës (shih, rastin e GJEDNJ-së *Hirvisaari kundër Finlandës*, nr. 49684/99, Aktgjykim i 25 dhjetorit 2001, paragrafi 30 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k.*, cituar më lart, paragrafi 115).
46. Neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykim i 29 janarit 1999, paragrafi 26; *Perez kundër Francës*, nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k.*, cituar më lart, paragrafi 116).
47. Nga natyra e vendimit që merr gjykata, varet nëse Gjykata është e detyruar ta arsyetojë atë, dhe kjo mund të vendoset vetëm në dritën e rrethanave të rastit në fjalë: është e nevojshme të merren parasysh, ndër të tjera, llojet e ndryshme të parashtrësve që një palë mund t'ia paraqesë gjykatës, si dhe dallimet që ekzistojnë midis sistemeve juridike të vendeve në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, pozicionet juridike dhe paraqitjen dhe hartimin e aktgjykimeve (shih, rastet e GJEDNJ-së *Ruiz Torija kundër Spanjës*, nr. 18390/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, nr. 18064/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k.*, cituar më lart, paragrafi 117).
48. Megjithatë, nëse parashtrësja e një pale është vendimtare për rezultatin e procedurës, ajo kërkon që t'i përgjigjet në mënyrë specifike dhe pa vonesë (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Ruiz*

Torija kundër Spanjës, të cituar më lart, paragrafi 30; *Hiro Balani kundër Spanjës*, të cituar më lart, paragrafi 28 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, cituar më lart, paragrafi 118).

49. Prandaj, gjykatat janë të obliguara që:
1. të shqyrtojnë argumentet kryesore të palëve (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Buzescu kundër Rumanisë*, [nr. 61302/00](#), Aktgjykim i 24 gushtit 2005, paragrafi 67; *Donadze kundër Gjeorgjisë*, [nr. 74644/01](#), Aktgjykim i 7 qershorit 2006, paragrafi 35); dhe
 2. të shqyrtojnë me shumë rigozitet dhe kujdes të veçantë kërkesat në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, KEDNJ dhe Protokollat e saj (shih, rastet e GJEDNJ-së: *Fabris kundër Francës*, [16574/08](#), Aktgjykim i 7 shkurtit 2013, paragrafi 72; *Wagner dhe JMWL kundër Luksemburgut*, [nr. 76240/01](#), Aktgjykim i 28 qershorit 2007, paragrafi 96).
50. Neni 6, paragrafi 1, nuk kërkon që Gjykata Supreme të japë një arsyetim më të detajuar kur ajo thjesht zbaton një dispozitë të caktuar ligjore lidhur me bazën ligjore për refuzimin e ankesës sepse ajo ankesë nuk ka një perspektivë për sukses (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Burg dhe të tjerët kundër Francës*, nr. [34763/02](#); Vendim i 28 janarit 2003; *Gorou kundër Greqisë* (nr. 2), [nr. 12686/03](#), Vendim i 20 marsit 2009, paragrafi 41; dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, cituar më lart, paragrafi 120).
51. Në mënyrë të ngjashme, në një rast ku bëhet fjalë për një kërkesë që të lejohet parashtrimi i ankesës, që është një parakusht për procedurën e një gjykate më të lartë, si dhe për një vendim të mundshëm, neni 6, paragrafi 1, nuk mund të interpretohet në atë kuptim që të urdhëron një arsyetim të detajuar të vendimit për refuzimin e kërkesës për parashtrimin e ankesës (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Kukkonen kundër Finlandës* (nr. 2), nr. [47628/06](#), Aktgjykim i 13 prillit 2009,) paragrafi 24; *Bufferne kundër Francës*, nr. [54367/00](#), Vendim i 26 shkurtit 2002; dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k.*, cituar më lart, paragrafi 121).
52. Përveç kësaj, kur refuzon një ankesë, Gjykata e Apelit, në parim, thjesht mund të pranojë arsyetimin e vendimit të dhënë nga gjykata më e ulët (shih, rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 26; shih, në kundërshtim me këtë, *Tatishvili kundër Rosisë*, nr. [1509/02](#), Aktgjykim i 9 korrikut 2007, paragrafi 62). Megjithatë, koncepti i procedurës së drejtë nënkupton që gjykata vendase që ka dhënë një shpjegim të ngushtë për vendimet e saj, qoftë duke përsëritur arsyetimet e dhëna më parë nga një gjykatë më e ulët ose në ndonjë mënyrë tjetër, në fakt merrej me çështje të rëndësishme brenda juridiksionit të saj, që do të thotë se nuk i pranoi thjesht dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Helle kundër Finlandës*, nr. [\(157/1996/776/977\)](#), Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 60 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k.*, cituar më lart, paragrafi 122). Kjo kërkesë është aq më e rëndësishme nëse pala në kontest nuk ka pasur mundësi t'i paraqesë argumentet e saj gojarisht në procedurën para gjykatës vendase.
53. Megjithatë, gjykatat e apelit (në shkallën e dytë) të cilat kanë juridiksion për të hedhur poshtë ankesat e pabazuara dhe për të zgjidhur çështjet faktike dhe juridike në procedurën kontestimore, janë të obliguara të arsyetojnë se përse refuzuan të vendosin për ankesën (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Hansen kundër Norvegjisë*, nr. [15319/09](#), Aktgjykim i 2 janarit

2015, paragrafët 77–83 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k.*, cituar më lart, paragrafi 123).

(ii) *Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret*

54. Së pari, Gjykata rikujton edhe një herë pretendimet e parashtruesve që ndërlidhen me mungesën e arsytimit të vendimit gjyqësor, ku ndër të tjera theksojnë se Gjykata Supreme me rastin e refuzimit të revizionit të parashtruesve të kërkesës, nuk kishte dhënë arsytim të mjaftueshëm lidhur me çështjen e parashkrimit absolut dhe relativ, duke shtuar se e njëjta nuk kishte adresuar pretendimin e tyre, se në rastin konkret ishte i aplikueshëm neni 358 (Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale) i LMD-së.
55. Sipas tyre LMD-ja çështjen e kërkesave të shpërblimit të dëmit e ka kategorizuar në dy nene të veçanta, respektivisht nenin 357 (Kërkesa e shpërblimit të dëmit) dhe nenin 358 (Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale). Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Supreme në rastin konkret gabimisht ka aplikuar dispozitat e nenit 357 të LMD-së lidhur me parashkrimin, dhe sipas tyre në rastin konkret duhet të aplikohet neni 358 i LMD-së, duke shtuar se “*kur dëmi është shkaktuar me vepër penale dhe për ndjekjen penale është parashkuar një afat më i gjatë i parashkrimit, kërkesa për shpërblim të dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të kaloj koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale dhe se në këtë rast gjen zbatim neni 358 i LMD-së.*”
56. Në vijim, Gjykata rikujton se Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 320/19] kishte miratuar pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës. Sa i përket prapësimit të ushtruar nga Kompania e Sigurimeve “Sigma” se padia duhet të refuzohet sepse e njëjta është parashkuar, Gjykata Themelore arsyetoi se një pretendim i tillë nuk qëndron për faktin se marrë parasysh nenin 376 të LMD-së afati i parashkrimit të padisë që ka për objekt shpërblimin e dëmit jomaterial është 5 vjeçar, dhe se afati fillon nga dita “*kur subjektit i ka lindur e drejta e padisë*” dhe se në rastin konkret është nga momenti kur Aktgjykimi [P. nr. 985/13] i 29 prillit 2015, ka marrë formën e prerë, respektivisht më 25 maj 2015.
57. Më tej Gjykata rikujton arsytimin e Aktgjykimit [CA. nr. 587/2020] të Gjykatës së Apelit i cili pasi miratoi ankesën e Kompanisë së Sigurimeve “Sigma” refuzoi si të pathemeltë kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës. Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimit të saj shtoi se parashtruesit e kërkesës nuk dëshmuan se brenda afatit 3 muaj prej kur “*aktgjykimi penal ka marrë formën e prerë përmes së cilit ishin udhëzuar në kontest civil, kanë paraqitur padi ë gjykatën e shkallës së parë, si kusht ligjor në kuptim të nenit 371.2 të LMD-së, që të konsiderohet se parashkrimi në këtë çështje është ndërprerë me fillimin e procedurës penale kundër personit përgjegjës në aksident e deri në përfundimin e saj me aktgjykim të formës së prerë*”. Më tej në arsyetim shtohet se nga data 25 maj 2015 prej kur aktgjykimi penal ishte bërë i formës së prerë e deri me 21 mars 2019, kur parashtruesit kishin paraqitur padi për kompensim të dëmit kanë kaluar më shumë se 3 muaj, ndërsa prej momentit të aksidentit kanë kaluar më tepër se 5 vite.
58. Për më tepër Gjykata Supreme në arsyetim të aktgjykimit të saj pasi e pranoi si të drejtë dhe të ligjshëm aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, si dhe duke konstatuar se i njëjti është mjaftueshëm i arsytuar, theksoi si në vijim “*gjykata e shkallës së dytë e ka arsytuar aktgjykimin e saj për të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura [...] afatet e përcaktuara me nenin 357 paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e detyrimeve janë afate prekluzive dhe të njëjtat afate nuk mund të zgjaten dhe as të shtyhen dhe se në rast*”

të kalimit të qfatit kërkesa arrinë parashkrimin, ndërsa gjykata sipas prapësimit të palës e vlerëson nëse kërkesa është parashkruar ose jo.” Gjykata Supreme duke u mbështetur në përmbajtjen e neneve 357 dhe 358 të LMD-së, theksoi se “Nga interpreteimi i këtyre dispozitave gjen zbatim në këtë rast për faktin se paditësit janë vënë në dijeni për dëmin dhe që i është shkaktuar dhe për shkaktarin e dëmit me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë Pejë P.nr.985/13 të datës 29 prill 2015, i formës së prerë nga data 25.05.2015, dhe nga data e fundit të aktgjykimit të formës së prerë deri në parashtrimin e padisë më datë 21.03.2019, nga paditësit kanë kaluar më shumë se 3 vite që nënkupton se kërkesëpadia e paditësve është parashkruar”.

59. Lidhur me pretendimin e parashtruesve se në rastin konkret janë të zbatueshme dispozitat e nenin 358 të LMD-së , Gjykata Supreme vlerëson se të njëjtat nuk qëndrojnë sepse “parashkrimi i kompensimit të dëmit lidhur me parashkrimin e ndjekjes penale deri në momentin kur nuk është vendosë me vendim të formës së prerë lidhur me veprën penale në procedurë penale, mirëpo në momentin që vendoset me vendim të formës së prerë konsiderohet se pala është në njohuri për dëmin dhe shkaktarin e dëmit dhe nga ky moment parashkrimi vlerësohet sipas dispozitës nga neni 357 të LMD-së.
60. Sa i përket pretendimeve të parashtruesve se në disa raste me rrethana të ngjashme Gjykata Supreme ka vendosur ndryshe, kjo e fundit konsideroi se këto pretendime nuk qëndrojnë pasi që rastet e dorëzuaranga parashtruesit e kërkesës në Gjykatë Supreme janë raste me rrethana të ndryshme, respektivisht raste në të cilat ende nuk është përfunduar procedura penale.
61. Si pasojë e gjithë asaj që u tha më lart, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta, kanë dhënë arsye bindëse dhe të mjaftueshme për refuzimin e ankesës së parashtruesve duke u bazuar në të gjitha argumentet e tyre të reflektuara më lart.
62. Lidhur me pretendimin e parashtruesve se në rastin konkret Gjykata Supreme është dashur t’i aplikojë dispozitat e nenin 358 të LMD-së, Gjykata rithekson, që interpretimi dhe zbatimi i ligjit është në kompetencën e plotë të Gjykatës Supreme.
63. Në lidhje me këtë, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar ndryshimin midis “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” duke theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin e gabuar dhe zbatimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla kanë mundur të shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose KEDNJ (shih, rastet e Gjykatës [KI128/18](#), parashtrues *Limak Kosovo International Airport Sh.A. “Adem Jashari”*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 majit 2019, paragrafi 55; dhe [KI110/19](#), parashtrues *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 tetorit 2019, paragrafi 40).
64. Gjykata, megjithatë, thekson se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, të përvetësuar nga Gjykata, edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në kuptimin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmerre masa kur vëren se një gjykatë ka zbatuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar në një rast specifik i cili mund të ketë rezultuar në “konkluzione arbitrare” (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Anheuser-Busch Inc., kundër Portugalisë](#), nr. 73049/01, Aktgjykim i 11 janarit 2007, paragrafi 83, [Beyeler kundër Italisë](#), nr. 33202/96, Aktgjykim i 5 janarit 2000, paragrafi 108; dhe shih rastin e Gjykatës [KI122/16](#), parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 59)

65. Gjykata, nga të gjitha shtjellimet e sipërtheksuara, në rrethanat e rastit konkret, konsideron se parashtruesit e kërkesës janë thjesht të pakënaqur me rezultatin e procedurës pranë gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e tyre nuk mund vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së [Mezotur-Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë](#), Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
66. Përveç kësaj, Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar dhe vendimi i shkallës së dytë, përmbajnë arsyetim logjik dhe sqarojnë me saktësi të gjitha pretendimet e parashtruesve të kërkesës (shih, rastet e GJEDNJ-së [Ruiz Toria kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 30; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 28).
67. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet për shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor dhe zbatimit të gabuar të ligjit, janë (i) pretendime që i takojnë kategorisë së pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”; dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

II. Pretendimet përkitazi me konsistencën e vendimeve gjyqësore

68. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës gjithashtu ngritin edhe pretendime se i) përmes vendimeve të gjykatave të rregullta janë trajtuar në mënyrë të pabarabartë në raport me të tjerët; ii) cenim të parimit të sigurisë juridike si rezultat i vendimeve kundërtënëse të gjykatave të rregullta.
69. Gjykata fillimisht thekson se parimet dhe kriteret e vendosura nga GJEDNJ, kjo Gjykatë gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve për cenimin e parimit të sigurisë juridike, si rezultat i vendimeve kundërtënëse i ka zbatuar edhe në praktikën e saj gjyqësore. (Shih rastet e Gjykatës [KI87/18](#), parashtrues “*IF Skadeforsikring*”, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019 dhe [KI35/18](#), parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, cituar më lart, [KI133/20](#), parashtrues *Raiffeisen Bank J.S.C.*, Aktgjykim i 30 marsit 2022; [KI78/21](#), parashtrues *Raiffeisen Bank J.S.C.*, Aktgjykim i 30 marsit 2022, ku Gjykata, ndër të tjerë, konstatoi shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të cenimit të parimit të sigurisë juridike, si rezultat i divergjencës në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së).
70. Duke iu referuar parimeve të përcaktuara të GJEDNJ, Gjykata rikujton se GJEDNJ-ja përdor tri kriteret themelore për të përcaktuar nëse një divergjencë e vendimeve gjyqësore e pretenduar përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, dhe të cilat përcaktojnë si në vijim: (i) nëse ekzistojnë dallime “*të thella dhe afatgjata*” në praktikën gjyqësore; (ii) nëse ligji vendor përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla; dhe (iii) nëse ata mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti (në këtë kontekst, shih rastet e GJEDNJ-së, [Beian kundër Rumanisë](#) (nr.1), nr. 30658/05, Aktgjykim i 6 dhjetorit 2007, paragrafët 37-39; [Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), nr. 76943/11, Aktgjykimi i 29 nëntorit 2016, paragrafët 116 - 135; [Jordan Jordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë](#), nr. 23530/02, Aktgjykim i 2 korrikut 2009, paragrafët 49-50; [Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë](#), nr. 13279/05, Aktgjykim i 20 tetorit 2011, paragrafi 53; dhe shih rastet e Gjykatës, [KI29/17](#), parashtrues *Adem Zhegrova*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 5 shtatorit 2017, paragrafi 51; dhe [KI107/19](#), parashtrues *Gafurr Bytyqi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 11 marsit 2020, paragrafi 74; dhe shih gjithashtu rastet e Gjykatës, [KI42/17](#), me parashtrues *Kushtrim Ibraj*, Aktvendim për papranueshmëri i 25

janarit 2018, paragrafi 39; KI87/17, parashtrues “*IF Skadiforsikring*”, të cituar më lart, paragrafi 67; KI35/18, parashtrues “*Bayerische Versicherungsverband*”, të cituar më lart, paragrafi 70).

71. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton pretendimin e parashtruesve të kërkesës se Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit në raste të ngjashme kanë nxjerrë vendime të ndryshme. Parashtruesit e kërkesës në mbështetje të këtij pretendimi në Gjykatë kanë dorëzuar 3 (tri) vendime të gjykatave të rregullta, në tri raste të ndryshme, respektivisht dy vendime të Gjykatës Themelore dhe një të Gjykatës Apelit.
72. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës në Gjykatë kanë dorëzuar Aktgjykimin [C. nr. 20/16] e 13 marsit 2023 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, Aktvendimin [C. nr. 850/2019] të Gjykatës Themelore në Prizren si dhe Aktgjykimin [CA.nr. 1556/2019], megjithatë nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dorëzuar parashtrësia tjera lidhur me këto dy raste, për të cilat kanë pretenduar lidhshmërinë faktike dhe juridike me atë të rastit të tyre.
73. Megjithatë, duke iu referuar rasteve të referuara nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata nga aktgjykimet e lartpërmendura vëren se të njëjta nuk kanë ngjashmëri me rastin e parashtruesve të kërkesës, sepse në Aktgjykimin [C. nr. 20/16 të 13 marsit 2023] të 13 marsit 2023 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, kishte miratuar kërkesëpadinë e K.P për kompensim të dëmit material e jomaterial duke e detyruar Byronë Kosovare të Sigurimit që si kompensim të dëmit jomaterial, t'i kompensojë anëtarët e familjes me vlerat përkatëse. Lidhur me kundërshtimin e Byrosë Kosovare të Sigurimit, me arsyetimin se e njëjta ishte parashkruar, Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, kishte refuzuar kundërshtimin, duke u bazuar në nenin 358 të LMD-së. Në Aktgjykimin [C. nr. 850/2019] të 26 korrikut 2023, duke vendosur për kompensim të dëmit jomaterial kishte hedhur poshtë padinë me arsyetimin se e njëjta është parashtruar pas kalimit të afatit ligjor, duke u thirrur në nenin 358 të LMD-së. Në Aktgjykimin [CA. nr. 1556/2019] të 19 gushtit 2022, Gjykata e Apelit kishte refuzuar ankesën e E.H ndaj vendimit të shkallës së parë, me të cilin ishte refuzuar kërkesëpadia për kompensim të dëmit jomaterial sepse e njëjta ishte parashtruar pas afatit të përcaktuar me nenin 358 të LMD-së.
74. Ndërsa në rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se Gjykata Themelore aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesve dhe e detyroi Kompaninë e Sigurimeve “Sigma” që për kompensim të dëmit, për dhimbje shpirtërore për humbjen e anëtarit të familjes, t’ua paguaj satisfaksionin anëtarëve të familjes. Lidhur me kundërshtimin e Kompanisë së Sigurimeve “Sigma” se kërkesa është parashkruar, Gjykata Themelore të njëjtën e refuzoi me arsyetimin se bazuar në nenin 376 të LMD-së afati fillon nga dita kur subjektit i ka lindur e drejta e padisë dhe është 5 vjeçar, dhe se në rastin konkret kundër vendimit të shkallës së parë, Kompania e Sigurimeve “Sigma”, parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar, ndër të tjera, se në rastin konkret ishte arritur parashkrimi. Gjykata e Apelit miratoi ankesën e Kompanisë së Sigurimeve “Sigma”, dhe refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesve të kërkesës, me arsyetimin se e njëjta ishte parashkruar, sepse në rastin konkret parashtruesit e kërkesës nuk dëshmuuan se brenda afatit 3 mujor prej kur aktgjykimi penal ka marrë formën e prerë përmes të cilit ishin udhëzuar në kontest civil, kanë paraqitur padi në gjykatën e shkallës së parë, si kusht ligjor në kuptim të paragrafit 2 të nenit 371 të LMD-së, që të konsiderohet se parashkrimi në këtë çështje është ndërprerë me fillimin e procedurës penale kundër personit përgjegjës në aksident e deri në përfundimin e saj me aktgjykim të formës së prerë. Gjykata Supreme, pas revizionit të paraqitur nga parashtruesit e kërkesës miratoi në tërësi aktgjykimin e Gjykatës Apelit, duke

vlerësuar se në kuptim të nenit 357 padia është e parashkruar dhe në rastin konkret nuk është i aplikueshëm neni 358 i LMD-së sepse parashkrimi i kompensimit të dëmit lidhur me parashkrimin e ndjekjes penale deri në momentin kur nuk është vendosur me vendim të formës së prerë lidhur me veprën penale në procedurë penale, mirëpo në momentin që vendoset me vendim të formës së prerë konsiderohet se pala është në njohuri për dëmin dhe shkaktarin e dëmit dhe nga ky moment parashkrimi vlerësohet sipas dispozitës nga neni 357 i LMD-së.

75. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme është i arsyetuar dhe se interpretimi i kësaj të fundit, sa i përket fakteve të paraqitura për vlerësim nga parashtruesi i kërkesës, nuk mund të thuhet se ishte arbitrar, i paarsyeshëm apo të ketë mundur të ndikojë në gjykim të drejtë, por ishte thjesht çështje e interpretimit dhe zbatimit të ligjit (shih në mënyrë analoge, rastin KI29/17, parashtrues *Adem Zhegrova*, të cituar më lart, paragrafi 57).
76. Duke rikujtuar detyrimin e përcaktuar përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës që parashtruesit e kërkesës duhet t'i paraqesin Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar në vendime kundërthënëse në praktikën gjyqësore, Gjykata vëren se përveç dorëzimit të dy vendimeve të Gjykatës Themelore dhe një vendimi të Gjykatës së Apelit, ku parashtruesi pretendon rrethanat faktike dhe juridike të ngjashme si ato në rastin e parashtruesit, parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur që Gjykatës t'i paraqesë argumente shtesë, apo raste tjera që janë vendosur ndryshe nga Gjykata e Apelit, dhe rrjedhimisht ta mbështesë pretendimin e tij për cenim të sigurisë juridike, si rezultat i vendimeve kundërthënëse të gjykatave të rregullta.
77. Andaj, në dritën e praktikës së vet gjyqësore, Gjykata vlerëson se nuk është e mundur të konstatohet ekzistimi i "*dallimeve të thella dhe të vazhdueshme*" në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit që rrezikojnë parimin e sigurisë juridike, duke u thirrur në dy aktgjykime të Gjykatës së Apelit (shih, në mënyrë analoge rastin KI29/17, parashtrues *Adem Zhegrova*, të cituar më lart, paragrafi 53).
78. Prandaj, Gjykata konsideron se as numri i aktgjykimeve të paraqitura si kundërthënëse, si dhe as mënyra se si Gjykata Apelit dhe Gjykata Supreme kanë vlerësuar dhe trajtuar rastin e parashtruesit të kërkesës nuk krijojnë bazë të mjaftueshme për të arsyetuar pretendimin për shkelje të parimit të sigurisë, si rrjedhojë e vendimeve kundërthënëse të gjykatave të rregullta (shih rastin KI29/17, të cituar më lart, paragrafi 58).

Përfundim

79. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet e sipërcekura të Kushtetutës, janë qartazi të pabazuara, sepse të njëjtat cilësohen si pretendime "*të pambështetura apo të paarsyetuara*" në baza kushtetuese.
80. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa, në tërësinë e saj, duhet të deklarohet qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht e papranueshme në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 1 dhe 7 dhe 116. 2 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 26 nëntor 2024, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- IV. TË KONSTATOJË se ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese



Selvete Gërxhaliu Krasniqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani